



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 20 maj 2022 në mbledhjen e X-të (dhjetë)-e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII.

E thirrur në kërkesë të 13 këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, nr.prot. 01-060/01-0033885/22 të datës 13 maj 2022, me pikën e rendit të ditës, Gjendja e rëndë e krijuar në arsim

Mbledhja filloi në orën 10;15, dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës, përveç z.Kasib Bashota i cili mungoi.

Gjithashtu në mbledhje i pranishëm ishin, drejtorët e Drejtorive (DA, DI, DPKGJ, DBPZHR, DSHMS, DPZHE, DKA,)

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe përfaqësues të mediave lokale dhe më gjerë, disa zyrtar komunal dhe një numër i qytetarëve.

Rendi i ditës

➤ Gjenda e rëndë e krijuar në arsim

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndeti të pranishmit, ndër të tjera theksoi, në bazë të listës së nënshkrimeve të pranishëm në sallë janë 34 anëtar/e të Kuvendit ndërsa mungon vetëm z.Kasib Bashota, andaj kuorumi ekziston për të vazhduar me mbledhjen.

Sot jemi në këtë mbledhje të jashtëzakonshme me kërkesë të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, dhe me mbështetje të 13 këshilltarëve nënshkrues është thirr kjo mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal me të vetmen pikë të rendit të ditës gjendja e rëndë e krijuar në arsim andaj e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

z.Qendrim Softolli, në cilësinë e iniciuesit të mbledhjes, theksoi, që nga fillimi i mandatit të qeverisjes lokale të udhëhequr nga LVV, Drejtoria e Arsimit është karakterizuar me parregullsi dhe skandale, duke filluar që nga rekrutimi i stafit, furnizimin e shkollave me material e deri te ndërhyrja flagrante në kompetencat e shkollave. Ishim me shpresë që këtë herë bazuar në të gjitha ato skandale që u prodhuan vitin e parë të qeverisjes që Kryetari do ta ndryshonte këtë formë të udhëheqjes brenda kësaj drejtorie, por ai zgjodhi që të vazhdoj me avazin e vjetër duke u bërë edhe ai vetë pjesë e tyre. Shkeljet filluan me emërimin e drejtorëve, listën e bursave, për të vazhduar me parregullsi pothuajse në secilin veprim, por para se të paraqes shumë parregullsi dhe shkelje ligjore të bëra qëllimisht nga Drejtoria e Arsimit sa për rikujtim dua të lexoj një citat nga fjalimi i drejtorit nga

mbledhja e mbajtur më 30 korrik 2020, po e citoj “karakteristikë e udhëheqjes së Drejtorisë së Arsimit prej që udhëheq ish Kryetari me të ka qenë vendosja e drejtorëve 100% të dëgjueshëm ku në një formë ose tjetrën ata vetëm formalisht kanë qenë aty pasi që me drejtorinë në fjalë ka udhëheq ai vet, sidomos te tenderët dhe punësimet klienteliste, por edhe duke punësuar njerëz të afërm të tyre dhe duke anashkaluar edhe persona me master të fushës së njëjtë”. Me keqardhje ju njoftoj se vetëm në vitin e parë të punës me skandale dhe punësime familjare, punësime pa konkurs dhe punësime jo meritore drejtori ia ka tejkaluar ish nënkryetarit. Paramendojeni sot personi i njëjtë është ulur në karrigen e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit dhe çdo ditë të Zotit i shkel këto pretendime që i ka ngritur vet një vit më parë. Kalojmë te pjesa kryesore ku z.Fetahu në cilësinë e personit zyrtar si drejtor i Drejtorisë së Arsimit me dashje dhe dijeni duke shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare apo autorizimet e tij që nga muaji janar 2021 e në vazhdimësi, me theks të veçantë në kohë fushate në muajt shtator, tetor, nëntor duke vepruar në kundërshtim me ligjet në fuqi që e rregullojnë fushën e punësimit duke bërë dhjetëra punësime të jashtëligjshme e me ç ‘rast ka shkelur një mori ligjesh duke filluar nga kushtetua e Kosovës, neni 49 e drejta e punës, ligjin e punës, ligjin për zyrtarët publik, ligjin për arsim në komuna, ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, kontratën kolektive të arsimit dhe një mori akte tjera nënligjore të cilat e rregullojnë procedurën e rekrutimit të zyrtarëve publik. Me këtë rast z.Fetahu ka konsumuar veprën penale nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar duke shkelur të gjitha procedurat ligjore për rekrutim të stafit në arsim. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në cilësinë e personit zyrtar ka punësuar dhjetëra militant aktivist dhe familjar të afërm me pushtetin duke i shpërblyer pa i respektuar procedurat e rekrutimit. Kjo shmangie dhe ky anashkalim i qëllimshëm i gjithë rregullativës ligjore që e rregullon fushën e punësimit nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit ta krijon përshtypjen se Komuna e Podujevës funksionon jashtë çdo rregullative ligjore që funksionon në Republikën e Kosovës. I nderuar Kryetar edhe pse nuk jeni i pranishëm në këtë mbledhje ju e dini se gjitha këto shkelje dhe të pa lara nuk ia lan as Llapi. Kisha dashtë ta pyes Kryetarin po të ishte prezent se a është i vetëdijshëm apo mos reagimi i tij në të gjitha këto parregullsi e bënë përgjegjës, njëkohësisht edhe fajtor ashtu siç e parasheh Kodi Penal i Republikës së Kosovës, e din sigurt por i ka kovenuar dhe ka heshtë. Heshtja dhe mos veprimi i Kryetarit është konsumim i veprës penale, ligji e thotë ashtu por siç po shihet për këtë qeverisje ligji është një tepihë që shkelet pa mëshirshëm çdo ditë. Të nderuar qytetarë ajo që është shumë e çuditshme se si për të gjitha këto fenomene të cilat kur ishte në opozitë i kritikonte çdo ditë nuk ka asnjë reagim nga Lëvizja Vetëvendosje, a e dini pse? Sepse drejtori ua ka blerë heshtjen duke ua punësuar familjarët, tash e ka grupin e vetë brenda lëvizjes dhe nuk guxon askush me ia prish tymin se i kërcënon me numra normalisht e kjo është e tmerrshme sidomos kur e she edhe heshtjen e asamblistë që edhe vetë punojnë në arsim, mosni more mos heshtni, për 10 orë ua ka ble heshtjen. Po ndalemi tani te një konkurs që shpërfaq shkeljet dhe ndërhyrjet flagrante të drejtorit të DKA-së, në përzgjedhje të stafit. Konkursi i fundit për pozitën mësimdhënëse për lëndët juridike dhe ekonomike në shkollën “Isa Boletini”, ku kërkoheshin dy ekonomistë me normë të plotë, vendi i lirë dhe dy juristë me normë të plotë dhe dy juristë me normë të plotë zëvendësim, e këtu alibia është se në pozitën mësimdhënëse për lëndët ekonomike sipas njoftimit të komisionit përzgjedhës i cili është i jashtëligjshëm sepse komisionet ndërtohen me një ligj tjetër tashmë. Pranohen dy mësimdhënëse me normë të plotë por kur vjen koha me fillu puna iu ofrohet kontratë me gjysmë norme me qëllim që t’i bëhen kontrata edhe dy kandidatëve tjerë, gjithë kjo është në kundërshtim me konkursin e shpallur dhe përbën shkelje të rregullativës ligjore, pra është mohim i të drejtave të punësuarve dhe shkelje e të drejtave të njeriut. Çka ka lidhje çka thotë ligji me rëndësi është qysh i konvenon drejtorit i cili procesin e rekrutimit e ka shndërruar në palë bile bile edhe atë në përcaktuese. Z. Drejtor këtë praktikë të

jashtëligjshme e keni zbatuar në vazhdimësi në çdo konkurs duke ju thënë “hajt se vjen shtatori ua plotësoj normën”, ku do me i marrë orët o drejtor kur e din se numri i nxënësve është duke rënë në vazhdimësi. Njëjtë keni vepruar edhe me mësimdhënësit e lëndëve juridike ku për 4 pozita të lira janë pranuar 5 mësimdhënës. Po ndalem te një praktikë e cila më parë shumë është kritikuar nga lëvizja e që është ndërhyrja në menaxhimin e shkollave shembull si askund tjetër në Kosovë në shkollën “Isa Boletini”, në kundërshtim me të gjitha rregullat me kërkesë të drejtorit i ndërrohet drejtimi nxënës në muajin mars, prej drejtimit ekonomik kalon në farmaci. Udhëzimi e parasheh në fund të periodës së parë se nxënësi mund të kaloj nga një profil në tjetrin e jo kur të duash ti drejtor se tek e fundit kjo nuk është kompetencë e juaj por çështje ekskluzive e drejtorit të shkollës. Çka është më e keqja, drejtori edhe pse me urdhrin e tij është bërë kjo, kur tema del jashtë kontrollit formon komision të dëgjueshëm kinse për të shqiptuar masë disiplinore ndaj stafit të shkollës e kjo është skandaloze. Këtu ka të përfshirë shumë njerëz e me këtë rast i ftoj edhe organet e drejtësisë që ta trajtojnë këtë çështje. Skandalet në shkollën ekonomike nuk ndalen me kaq zëvendës drejtoreshës së emëruar e cila është promovuar si prurje e re në LVV, nga vetë prurja e asaj kohe z.Fetahu, i kërkohej nga shefat e saj të japë dorëheqje dhe menjëherë pastaj nxjerret vendimi dhe caktohet ushtrues detyre aty ku është edhe sot pa asnjë procedurë të zhvilluar. Mos të harrojmë se po bëhet një vit e gjysmë dhe në shkollat tona ushtrues detyre në pozitat udhëheqëse kjo derisa të vijë në konkurs njerëzit e drejtorit, ndërsa disa ish drejtor dikur koleg të drejtorit në mënyrë arbitrare edhe pasi kanë kaluar të gjitha procedurat e rekrutimit u pamundësohet zgjedhja, drejtori e din se për kënd e kam fjalën, ka raste kur drejtorët i kanë përfunduar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe në fund është anuluar konkursi dhe janë emëruar ushtrues detyre këta ushtrues janë specialistë të arsimit, nuk janë të dëgjueshëm, janë merit sepse parimet dhe meritokracia janë shahadeti i punës së drejtorit. Ashtu siç u cek krejt në këtë fjalim, e do të potencohet edhe në fjalime tjera. Drejtori po del të jetë shumë i mençur, kur ka qenë drejtor i bujqësisë heshtjen ua blejke me pajisjet e subvencioneve të bujqësisë, tash heshtjen po ua blen duke ua punësuar familjarët, strategji se jo mahi dhe krejt në fund për të gjitha këto që u ceken edhe ato raste për shkak të ndjeshmërisë që nuk u ceken me emra ndonëse i kemi ne si subjekt kemi adresuar kallëzim në prokurorinë për krime të rënda, kallëzim në agjencinë anti korrupsion, kemi dërguar shkresë në zyrën e auditorit të përgjithshëm dhe në ministrinë e pushtetit lokal. Meqenëse auditorët janë në proces të punës në komunën tonë i ftoj që faktet dhe dëshmitë që paraqiten gjatë seancës të konsiderohen si prova për arsye për të hulumtuar këto raste.

znj. Adelina Stublla, theksoi, ne Grupi i LVV-së, në vazhdimësi e kemi përcjellur gjendjen në arsim edhe sa kemi qenë në opozitë e tash edhe në pozitë, kemi dhënë vërejtje dhe sugjerime dhe shpeshherë kritika sepse prioriteti ynë ka qenë të kemi një arsim cilësor, edhe në këtë seancë dëshirojmë ta kuptojmë se si përpjekje e jona sqarime t’i japim ashtu siç e meriton. Ne e dimë se në çfarë gjendje e kemi gjetur gjendjen në arsim dhe në çfarë gjendje është tani. Fillimisht nuk mund të ketë arsim cilësor pa pasur investime në arsim e që programi i LVV-së, dhe Kryetarit të Komunës kanë qenë investimet në arsim dhe atë duke filluar nga investimet në infrastrukturë e deri te mjetet e konkretizimit, për një arsim të avancuar përmes kabineteve dhe formave tjera bashkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ne po i përmendim disa nga investimet në arsim, 7 shkolla me investim për eficiencë me vlerë 895,248.00€, për shkollat; shkolla “Shaban Shala”, Podujevë, shkolla “Shefki Kuleta”, në paralelen e ndarë fizike në fshatin Bellopojë, shkolla “Enver maloku”, në Podujevë, shkolla “Luigj Gurakuqi”, në paralelen e ndarë fizike në fshatin Gërdofc, shkolla “Ali Ajeti”, në paralelen e ndarë fizike në fshatin Ballofc, shkolla “Hamit Sejdiu”, në paralelen e ndarë fizike në fshatin Pakashticë, shkolla “Shefki Kuleta”, në fshatin Tërnavë. Shpërndarja nëpër shkolla e 112 titujve me 30000 ekzemplarë të detyrave shkollore, finalizimi i dy projekteve për rregullimin e

hapësirave të jashtme shkollore në të dy objektet shkollore “Enver Maloku”, në Podujevë dhe në objektin e shkollës fillore “Ali Ajeti”, në fshatin Sfeçël. Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Podujevës dhe Karitasit Zvicrran, në fushën e edukimit parimor, vlera e projektit 12,500.00€, ku Komuna e Podujevës participom me 3,750.00€, ndërsa Karitasi Zvicrran participon me 8,750.00€. Kemi pranuar donacion me 93 pako higjienike me dezinfektues, termometër dhe mjete tjera higjienike, kemi pranuar donacion nga Gizi gjerman me vlerë 2,000.00€, për dy qendrat mësimore për komunitetin jo shumicë. Janë shpërndarë 21 fotokopjues multifunksional në shkollat që kanë pasë nevojë, kemi pranuar donacion nga Ministria e Arsimit 22 llaptop, kemi pranuar donacion 82 kompjuter nga dogana e Kosovës. Nga kompania cving me pronar Ardin Aliu, kemi pranuar donacion 20 kompjuter për nxënësit e shkollës “Fan S Noli”, në Podujevë. Kemi realizuar memorandumin e bashkëpunimit në mes të kompanive stengford dhe stengford fluid në shkollën “Isa Boletini”, në Podujevë. Në këtë vit shkollor gjendja e sigurisë në shkollat e Komunës së Podujevës është e qetë stabile dhe e sigurtë, aktivitetet e realizuara në fushën e sigurisë, mbledhja me drejtorët e shkollave, fuqizimi dhe funksionalizimi i plotë i organeve qeverisëse udhëheqëse dhe profesionale të shkollave, zgjerimi i shërbimit psikologjik dhe pedagogjik, sigurimi i transportit të nxënësve, ndërtimi dhe renovimi i objekteve shkollore, rregullimi i rrethojave të oborreve të shkollave, shujta për nxënësit kërkesë kjo e kahëmotshme e jona, në mënyrë që nxënësit të ndjehen të barabartë. Ndërtimi dhe rregullimi i trotuareve për këmbësorët, bashkëpunimi i DKA-së me policinë e Kosovës, instalimi i kamerave të sigurisë, pastaj 1,500,000.00€, janë ndarë nga niveli komunal vetëm për këtë vit 79,000.00€ nga banka botërore, ndërtimi i n jë çerdhje pas 20 viteve, këndi i lodrave për fëmijë, është në finalizim shkolla “Ali Ajeti”, në fshatin Ballofc, furnizim me makina pastrimi, kositëse bari, tv monitor, intervenim në renovim të 31 shkollave në vlerë prej 440,000.00€, rrethojat e objekteve shkollore, furnizimi i të gjitha shkollave me lektyra të pasura shkollore, vendosja e kamerave në të gjitha shkollat gjë që na ka dhënë mundësinë që rojet e natës t’i sistematizojmë nëpër oborret e shkollave për mirëmbajtjen e tyre. Pajisjet me laborator për 23 shkolla dhe 11 janë në proces dhe ky aktivitet po përmbyllet sivjet për t’i dhënë hapësirë viti të ardhshëm vendosjes së tabelave digjitale e moderne, pajisje me të gjitha mjetet e konkretizimit dhe inventar modern në 5 klase të nivelit parashkollor me karitasin zvicrran dhe tani së fundi me nënshkrimin e marrëveshjes për themelimin e klubeve të gjelbërta nëpër shkolla. Ne LVV do të vazhdojmë të punojmë për të mirën e qytetarëve e sidomos për të mirën e nxënësve që janë ardhmëria e këtij vendi.

z.Bashkim Sylja, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, siç e dimë gjendja në arsim nuk është e mirë, kjo gjendje është e trashëguar, mosdhënia e prioritetit për arsim na ka kushtuar gjithëherë sidomos në këtë qeverisje prioritet i është dhënë arsimit sepse është rrit buxheti dhe janë bërë investime në disa shkolla, në çerdhe dhe janë furnizuar disa kabinete. Është miratuar rregullorja për funksionimin e institucioneve edukativo-arsimore, natyrisht ne nuk jemi të kënaqur me gjendjen që është tani, mirëpo duhet shumë punë dhe shumë kohë që kjo gjendje të ndryshoj.

z.Gazmend Islami, theksoi, nuk e di a është thirrur kjo mbledhje për shkak të gjendjes së rëndë në arsim, për shkak të problemeve të shumta që janë bërë apo është thirrur me na tregue se sa janë bërë investime, këtë nuk po mund ta dij. Këto që i ceku znj. Adelina Stublla, jam i kënaqur me ato investime, mirëpo nuk është mirë me u thirr asnjëherë e sidomos nga LVV, se e kemi trashëguar një gjendje shumë të keqe në arsim. Kryetarin e tanishëm e keni pas 8 vite drejtor të Drejtorisë së Arsimit, çka jeni duke thënë tani, a duhet t’i thoni Kryetarit mos folni tash, nëse tani ka aq shumë parregullësi në arsim ai (Kryetari) ka qenë drejtor i Drejtorisë së Arsimit. Drejtori i tanishëm i Drejtorisë së Arsimit ka qenë njeri shumë i afërt i ish Kryetarit z. Agim Veliu, tani ky transferimi i madh që është duke e bërë ky e që njihet si njeri që ka kontribuar shumë për LDK-në e tani ka kaluar

në LVV, nuk ka politikë, nuk ka studim, nuk ka provim që mund e mëson në shkollë e t'i biesh në fije çka drejtin përfaqësojnë këta njerëz, kush janë këta. Nuk ka askund në botë njerëz që sa herë vijne zgjedhjet katapultohen herë në anën e majtë e herë në anën e djathtë, e kanë pështjellë logjikën nuk e dimë se kënd e përfaqësojnë. Unë e di që ka shkelje, zakonisht bëhen shkelje sidomos te emërimi i drejtorëve dhe te përzgjedhja e mësimdhënësve, unë uroj që drejtori t'i merr shumë seriozisht këto gjëra sepse, po ua japë fjalën se nuk do të ketë Gjykatë që s'do të kërkojë që të sjellet drejtësia. Nuk do të ketë më procedura që ëdo herë bëhen shkelje ligjore sepse secili prej nesh duke filluar nga ana e djathtë deri në anën e majtë e dimë që ka punësime familjare, këto i ka bërë edhe LDK-ja më parë por këta po i bëjnë pak më shumë se ju, pra janë kah e rritin trendin e punësimeve familjare, kjo praktikë nuk është e mirë. Nuk e kemi asnjë reformë në arsim i nderuari drejtor, s'ka asgjë, dje i keni postuar dy foto me një kompani për shkollat profesionale mirëpo ajo nuk është asgjë, s'ka logjikë ajo, s'keni kurrfarë plani se si funksionojnë shkollat profesionale dhe si bëhet lidhja e tyre me bizneset. Nuk mund të ketë sukses nëse një nxënës i shkollës profesionale nuk e ka një lidhje me drejtimin përkatës që e ka me biznesin i cili kryen po atë punë qoftë murator apo elektrikist, pra krahas shkollës duhet edhe puna, pra ajo është shaka, na keni lodhur me këto foto të përditshme. Me dëgju çka jeni duke postuar ju unë për vete them ku jam duke jetuar, a jam duke jetuar në Amerikë, a jam duke jetuar në Gjermani apo jam duke jetuar në Podujevë, nuk them këtu me inati asgjë, kam knaqësi që të punohet për të mirën e këtyre qytetarëve, me mish e shpirt e dua këtë vend, i dua njerëzit e ndershëm, i dua njerëzit punëtor, i dua ata njerëz që e duan vendin e vet dhe e kanë përnjëmend. Nuk jemi ndonjë parti e madhe, jemi parti e djathtë konservatore që e përcjellë mesazhin e atyre votuesve të mi, e dua këtë vend më shumë se çdo gjë në botë prandaj duhet me i thënë mendjes, duhet me thirrë trurin tonë se këta qytetarë presin prej neve me ua lehtësu jetën e jo me bërë gjëra të pista me idiotizma me punësime familjare, me orë gjysmake, këto janë të tmerrshme prandaj nuk mund ta kuptoj këtë. Uroj që me marrë seriozisht këtë Kryetari i Komunës, drejtori i DKA-së, partitë të cilat janë në pushtet dhe opozita që bashkalisht e sifomos te punësimet na duhet një bashkëpunim i sigurt mes pozitës dhe opozitës dhe me i dhënë kahje të re arsimit sepse fundi i fundit për ata nxënës unë i njohë këtu disa asamblist që janë edhe profesor e të cilët kanë dëshirë që nxënësit e tyre të jenë të suksesshëm, prandaj ne nëse punojmë bashkalisht pa inate pa ndërkëmbca mund t'i bëjmë disa punë të mira për vendin tonë se shkollimi cilësor është ardhmëria e vendit tonë.

znj.Mrika Thaçi, theksoi, dola në këtë foltore sepse kur trajtohet një temë siç është kjo e arsimit, ardhmëria dhe edukimi i pasardhësve tanë padyshim se nuk mund të jem indiferente, unë kisha dashtë shumë që sot të bisedohet për të arriturat dhe sukseset në arsim dhe për çudi kjo mbledhje e jashtëzakonshme sot po rastisë me grevën e përgjithshme në arsimin e Republikës së Kosovës. Pa dashur të kërkojë fajtor për këtë gjendje të krijuar jo vetëm nga ne por edhe për periudhat më të gjata kohore, përpjekjet e mia komform kompetencave të një anëtarje të Kuvendi do i orientoj në mbështetje të çdo veprimi në të mirë të arsimit dhe në distancim nga çdo veprim që do të thotë të kemi një arsim të mirëfillt se findja fëmijët dhe arsimi janë baza e një shoqërie prosperuese dhe demokratike.

z.Qendrim Softolli, theksoi, për gjendjen e infrastrukturës në arsim, kolege (i drejtohet znj.Adelina Stublla), do të shihemi në një seancë tjetër por këtu bëhet fjalë për rreth 100 punësime pa konkurs, kjo që e lexoj kolegja po e dëshmon atë që e ceka unë më herët që heshtjen po ua blen drejtori dhe po harron që sot në tërë territorin e Republikës së Kosovës është grevë për gjendjen në arsim dhe njeriu i fundit që duhet me fol kolege je ti, këtu edhe shefe edhe jashtëligjshëm je e emëruar kryeinfermiere, lënda është edhe në agjencinë antikorruption.

z.Florent Hasani, theksoi, kërkojmë llogari se si u marrë vendim për rrënimin e një objektit monumentin me vlera të larta kulturore e arsimore në Llap, fjala është për shkollën e parë shqipe në Podujevë ku kishte filluar veprimtarinë edukativo-arsimore e Gjinnazit të parë. Objekt ky që së fundi ka funksionuar si shkollë fillore e që ka qenë shkolla “Naim Frashëri”, kërkojmë nga personat kompetent që të fillojnë hulumtimin dhe të gjejnë përgjegjësit që e morrën atë vendim makabër, vendim i cili mund të quhet vendim edhe krim. Krim që ka dëmtuar rëndë trashëgiminë kulturore, arsimore shqiptare në trevën e Llapit, përgjegjësit e atij skandali që janë pjesë e qeverisjeve të kaluara duhet pa tjetër të japin llogari para drejtësisë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, po i përgjigjem kolegut parafolës për të cilin kam respekt, duhet me ditë që Kryetari aktual i Komunës ka qenë drejtori Drejtorisë së Arsimit, punët mirë i ke me të, shko në zyre e pyete pse e ka rrënuar atë objekt dhe të tregon direkt përgjigjen. Drejtorin aktual të Drejtorisë së Arsimit e ke pasë në të gjitha pozitat në LDK, se këtu ka drejtorë të cilët nuk mund të rrijnë pa pushtet andaj kah shkon pushteti shkojnë edhe ata, pastaj çuditësh kur i sheh herë në anën e djathtë ku dojnë me i lënë mendë prej orinetimit të djathtë e herë në anën e majtë ku dojnë me i lënë mendë prej orinetimit majtë politik, pastaj kurrë se din se çka u bë.

z.Ragip Fetahu, theksoi, sistemi i arsimit parauniversitar në vendin tonë është me të vërtetë para disa sfidave dhe një nga problemet kryesore është edhe dërgimi i nxënësve nëpër shkolla. Sipas statistikave të agjencisë së Kosovës kemi zvogëlim kontinuel të numrit të nxënësve nëpër institucionet shkollore derisa në vitin 2015-2016, kishim 342,370, nxënës në Republikën e Kosovës, në vitin shkollor 2018-2019, kemi rreth 318000, nxënës kurse gjatë vitit shkollor 2020-2021, ky numër kishte rënë në 294000 nxënës, nëse i krahasojmë periudhat kohore brenda 5 viteve në shtetin tonë kemi minus 47720, nxënës. Tash pse po ndodh kjo, cilat janë arsyet e largimit të këtyre nxënësve pse nuk kemi greva ne për këtë çështje, pse ky trend i ikjes aq i lartë. Në anën tjetër kemi kërkesa vetëm materiale por jo zgjidhje të problemeve mbi baza praktike. Ky trend i tkurrjes së numrit të nxënësve në shkollat tona do të vazhdojë edhe në vitet pasuese bazuar në të dhënat statistikore. Nga ky fenomen sigurisht se është prekë edhe komuna jonë dhe për këtë mund t’ju them se vetëm në shkollën “Shaban Shala”, këtë vit janë lëshuar mbi 100 fletlëshime për nxënësit, faktor shtytës janë prindërit dhe familjet e tyre kurse faktor nxitës janë migrimi dhe emigrimi. Arsyet e largimit të nxënësve në komunën tonë janë kryesisht të natyrës ekonomiko-sociale dhe kërkesa për një jetë më të mirë, unë mendoj se sfida kryesore e komunës tonë është harmonizimi i numrit të mësimdhënësve me numrin e nxënësve në rënie. Nuk mund të ketë punësime në konkurse të reja pa e analizuar mirë situatën e orëve nëpër shkolla, sipas kontratës kolektive nëse një mësimdhënës mbetet pa orë mësimore DKA, është e detyruar ta kompensojë atë me pagë deri sa atij ose asaj t’i gjenden orët mësimore, por edhe me kontratë drejtoria detyrohet t’i plotësojë orët e mësimdhënësve. Problematikë tjetër në komunën tonë është edhe depolitizimi dhe departizimi i shkollave, në asnjë mënyrë, asnjë rrethanë sistemin arsimor nuk duhet ta përziejme me çështjet politike dhe këtë pop e përmbyll me një citat decidiv ku thuhet se shkolla nuk është ent social i punësimit por institucion ku dija dhe meritokracia do të jenë në rend të parë.

znj.Edona Shabani, theksoi, nuk duhet me qenë ekspert për me ditë për skandalet e drejtorisë së arsimit, mjafton me i pa shkrimet në media dhe bindesh, çdo ditë nga një skandal, këto veprime të bëjnë me mendu se arsimiti në komunën tonë është ka udhëhiqet prej njerëzve që sillen si pronar. Çdo ditë ju bëhen kontrata pune njerëzve pa konkuru hiç, kjo na e kujton skandalin e famshëm pronto e në atë skandal shef i shefave ishte Adem Grabovci, ndërsa te ne shefi i shefave është Avni Fetahu, të shtin në punë pa konkuru hiç, nëse për asgjë nuk ka suksese qeverisja e vetëvendosjes në Llap le të krenohen se e kanë sjellë versionin e Adem Grabovcit në Podujevë urime ju qoftë.

z.Florent Hasani, theksoi, në periudhën kur është rrënuar shkolla fillore “Naim Frashëri”, në Podujevë, drejtor i Drejtorisë së Arsimit nuk ka qenë Kryetari aktual i Komunës, por drejtor i Drejtorisë së Arsimit në atë kohë ka qenë Avni Maloku dhe Kryetar i Komunës ishte z.Agim Veliu. Këtë temë nuk e ngrita politikisht, kushdo qoftë ai person mendoj se duhet dhënë llogari para organeve të drejtësisë.

z.Naim Çunaku, theksoi, fjalimin tim po e nisi me një fakt që mendoj unë që është shumë i rëndësishëm dhe interesat për komplet procedurën e rekrutimit të zyrtarëve publik, po e përdori një metodë krahasuese, komperative, me vete kam sjellë një konkurs dhe atë qëllimshëm e mora nga Komuna e Gjilanit, komunë kjo që udhëhiqet nga vetëvendosja dhe partnerët e njëjtë të koalicionit si në komunën tonë. Për dalim prej Komunës së Podujevës atje fushën e arsimit sa i përket procedurave të rekrutimit bëhen në bazë të ligjit për zyrtarët publik, me të gjitha procedurat e rekrutimit nga njësia e burimeve njerëzore. Thash i mora shembull dy konkurse që janë shpallë, njëri në komunën e Gjilanit dhe njëri në komunën e Podujevës, po ta lexosh bazën ligjore të bën të kuptosh se të dy thirren në Republikën e Kosovës por jo me ligje të njëjta në Republikën e Kosovës, po vazhdoj te ne edhe si sot në vazhdimësi kritikohet sistemi i udhëheqjes 20 vjeçare edhe në komunën tonë dhe gjithandej Kosovës, por Drejtoria e Arsimit dhe jo vetëm ajo vazhdon dhe i zhvillon procedurat sipas këtyre praktikave, praktikave 20 vjeçare nga shembulli që përmenda është duke vazhduar me atë praktikë, tash mei bë krejt këto parregullësi me punësime që u shfaqen këtu po më bënë të kuptoj se kjo bëhet qëllimisht për të mundësuar favorizime në punësime me motive të cilat nuk mund t’i quaj motive të mira, për ta thjeshtëzuar më shumë me hyrjen në fuqi të ligjit për zyrtarët publik të gjitha procedurat e rekrutimit të zyrtarëve publik e që janë edhe të punësuarit në arsim duhet të bëhen sipas ligjit në fuqi. Ky ligj ka hy në fuqi në vitin 2020 dhe tani jemi në vitin 2022, ne veprojmë jashtligjshëm, çka i bie kjo, organizimi i procedurave të rekrutimit nuk po bëhet përmes sistemit elektronik të shpalljes së konkurseve si dhe nuk është bërë publikimi përmes procedurave siç e parasheh sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore. Sistem ky që me ligjin në fuqi është bërë për t’i evituar parregullësitë që historikisht janë duke u shfaqur te ne dhe gjithandej Kosovës duke krijuar favore dhe disfavore në punësim, për ta thjeshtëzuar edhe më tej kjo shmangie e ligjit të ri qëllim në vete ka për t’i shmangur procedurat e konkurimit që i parasheh ky ligj sepse me të kërkohet jo vetëm hapja e procedurave të konkurimit në afat 30 ditësh pastaj procesi i testimit prej 15 ditëve, shto këtu edhe afatet kohore të ankimimit që përafërsisht merr një kohë më se 2 mujore, ndërsa në komunën tonë trup e shkurt mund të kryhet për 15 ditë, madje madje edhe më shpejt. Po flasim edhe për përbërjen e komisioneve ku sipas ligjit me të cilin po realizohet procedura e rekrutimit që tani janë të tejkaluara ngase tani e kemi ligjin e ri në fuqi, DKA komisionin e pranimit e bënë shpeshherë me njerëz që nuk janë as njohës të fushës së arsimit me përbërje prej 3 anëtarëve, ndërsa ligji i ri e parasheh përbërjen e komisionit prej 5 anëtarëve, prej tyre 3 të fushës, 1 ekspert i jashtëm dhe 1 anëtarë nga burimet njerëzore. Kur të gjitha këto i përmend nuk më mbetet asgjë tjetër vetëm se ta parafrazoj një thënie të ish kryeministrit anglez të viteve të 50-ta, kur ndalohet duhan pirja në Angli dhe vendosen tabelat që ndalojnë pirjen e duhanit, mirëpo në atë vend ku ka qenë e vendosur tabela shiheshin 20 apo 30 persona duke mos e respektuar ligjin dhe detyrohet të thotë hiqne ligjin se ne nuk i detyrohemi ligjit. Në fund z. Kryesues besoj se për shkakqe koorrektësie për mostejkalim të kohës gjegjësisht për mosshkelje të rregullores, në minutat shtesë që mi lejon rregullorja te minutat për sqarim dhe plotësim do t’i japë disa shembuj konkret, ju faleminderit, vëmendja juaj më nderon.

z.Gazmend Islami, theksoi, e kam vetëm një pyetje për drejtorin se shumica e nxënësve nëpër fshatra, konkretisht në fshatin Dumnicë njohë shumë familje që fëmijët e tyre i dërgojnë në shkollë në Podujevë, pra anashkalohet shkolla që është më e afërt, në bazë të cilit kriter bëhet kjo, kur dihet

se numri i nxënësve është shumë më i vogël se sa duhet të jetë. Në vendet perendimore është praktikë që asnjë nxënës nuk mund ta tejkaloj shkollën që e ka më të afërt dhe nuk mund të pranohet në shkollat tjera, pra nëse vazhdojmë me këtë logjikë e që shembull e mora fshatin Dumnice që ndoshka ka 70 apo 80 nxënës që mësimet i vijnë në shkollë në Podujevë, andaj nuk duhet të lejohet të zbrazen shkollat në fshatra për shkak se prindërit mendojnë se cilësia e arsimit është më e mirë në qytet, kjo mendoj se është në të mirë të qytetit që mos të lejohet që nxënësit nga fshati mësimet t'i vijnë në Podujevë, kjo të ndalohet me ligj ashtu siç është gjithkund në botën perendimore. Num mundet djali im t'i vijoj mësimet në Podujevë kur prej shtëpisë e ka 500 metra afër shkollën, për shkak se unë mendoj se shkolla është më e mirë kur profesorët janë të njëjtë, gradat arsimore i kanë të njëjta, prandaj mendoj se është njësoj dhe propozoj që të trajtohet kjo temë dhe ta shihni të arsyeshme.

z.Adnan Zymeri, theksoi, më datë 24.05.2021, saktësisht para një viti me mbështetjen e këshilltarëve nënshkrues kam deponuar kërkesën për mbledhje të jashtëzakonshme mbi gjendjen në arsim, kujtoj në atë kohë se si shkas ka qenë ndarja e pa drejtë e bursave për nxënësit dhe studentët por pa përjashtuar projeksionet elektorale që dolën të jenë të sakta në fund të vitit. Pas një viti kur po diskutojmë për gjendjen në arsim logjika mbetet e njëjtë sepse njerëzit janë të njëjtë sikur para një viti duke mos dashur të minoj asgjë nga progresi eventual. Sa herë diskutohet për arsimin gjithmonë ka hapësirë për tu përmirësuar sidomos kushtet e punës me të cilat personeli arsimor punon që nisin nga pagat dinjitoze e për fat të keq paga të cilën sot e marrin gjithçka mund të jetë, vetëm e dinjitetshme nuk është, për rastësi ashtu siç e ceku kolegeja znj.Mrika Thaçi, deri sa ne po diskutojmë ata protestojnë për të kërkuar trajtim meritore të munguar tash e një vit. Element tjetër të cilit duhet t'i kushtohet rëndësi të veçantë që është parakusht për zhvillimin e procesit arsimor është siguria. Nuk janë të pakta rastet kur shohim dhe dëgjojmë për grupe nxënësish gangsterë të cilët shkollën e shohin më shumë si arenë për qerim hesapësh se sa si vend ku zhvillohet procesi i mirëfilltë edukativo-arsimor. Sikur të mbaronte me kaq sepse ka raste të tjera kur nxënësit kërcënohen nga grupe të tilla për përfitime pasurore. Siguria nuk është as e LDK-së, dhe as e LVV-së, që do të thotë se është proces mbi partiak për të cilin duhet të angazhohemi të gjithë. Në aspektin legjislativ ekzistojnë ligje, udhëzime administrative, strategji dhe ato tjera nënligjore që ndalojnë ç'do lloj dhune ndaj fëmijëve. Aspektet e sigurisë nëpër shkolla trajtohen edhe nga strategjitë nacionale për siguri në bashkësi, në protokolin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar si dhe në rregulloret e shkollës. Të gjitha këto dokumente thjeshtë mbesin në letër pa bashkërendim të aktiviteteve të institucioneve përkatëse duke ndjekur modelet më të mira të rritjes së sigurisë nëpër shkollat tona. Përderisa arsyetohemi se është kompetencë e këtij apo e atij dëmi që mund të ndodhë nuk pyet për kompetenca, prandaj unë rekomandoj që të themelohet taskë forca për monitorimin e gjendjes së sigurisë në shkolla sikurse edhe në vendet perendimore në përbërje të prindërve, policisë dhe menaxhmentit të shkollave, gjetja e formës së sigurimit në shkollë, gjegjësisht shtrirja e kamerave të sigurisë krejt këto masa të merren me qëllimin më të mirë që shkolla të jetë vend i progresit shumë dimensional për nxënësit tanë.

z.Demokrat Hodolli, theksoi, është kjo seancë e jashtëzakonshme rreth gjendjes në arsim dhe po e shoh të arsyeshme me fol rreth një çështje. Më datë 18.04.2017, Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës në bashkëpunim me sindikatat e bashkuara të arsimit ka lidhur një kontratë. Kontratë e cila parasheh ndarjen e shujtave në vlerë prej 2€, për ditë të mësimet, për të gjithë mësimdhënësit, këto shujta është dashur të ndahen nga niveli lokal. Shujta parashihet në kontratën kolektive të arsimit që është e nënshkruar dhe është në fuqi do të thotë Komuna e Podujevës, konkretisht qeverisja e juaj është dashur të bëjë planifikime buxhetore edhe pse kjo çështje nuk është marrë shumë seriozisht edhe pse është premtuar, prandaj mësimdhënësit nga komuna jopnë kanë ushtruar padi ndaj

komunës në mënyurë që përmes gjykatës t'i realizojnë të drejtat e tyre. Mendoj se nuk ka pasur nevojë fare për procese gjyqësore por të merren shembull shumë komuna tjera të Kosovës të cilat kanë filluar t'i kryejnë këto obligime. Shpresoj se komuna jonë nuk do të lejojë të zvarritet ky proces dhe të bëhen ndasitë sië kanë filluar në disa shkolla, shpresoj në këtë drejtim dhe në punë konkrete.

z.Valon Demolli, theksoi, fillimisht kërkoj nga drejtori i DKA-së që për të gjitha këto pyetje që u parashtruan le të del dhe të deklarohet.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, fillimisht nga inicuesi i seancës dua ta di sepse në fillim doli dhe i përfshiu të gjithë se kanë bërë punësime familjare në arsim, unë desha ta di se a e bëri këtë nga mos dija apo nga ngutia sepse po akuzon dhe është e pa drejtë. Unë me dijen time jo vetëm në arsim por me asnjë gjë që ka të bëjë me Komunën e Podujevës asnjë familjar i imi nuk ka përfitime kështu që nëse ka diçka le ta thotë përndryshe le ta tërheqë fjalën.

z.Qendrim Softolli, i përgjigjet parafolesit, theksoi, shumë shkurt nëse nuk të është rahatuar ende ndonjë anëtar në rend është.

z.Xhevdet Maloku, replikë me parafolesin, theksoi, se çka është në rend veç Zoti e din, nuk mundesh me ditë ti meqenëse më heret e përmende shahadetin, ndoshta të lidhet.

z.Gazmend Islami, theksoi, drejtor (i drejtohet drejtorit të DKA-së) kam edhe një pyetje është mirë me na këqyr në sy kur të flasim se këtu nuk jemi duke bërë humor por kemi ardhur për t'i shpreh qëndrimet tona. Kemi një shqetësim tek nxënësit gjatë pushimeve në orarin mësimor se është e ndaluar me ligj që nxënësit gjatë orarit të pushimit ta kalojnë oborrit të shkollës, te ne nëse kalon rrugën Podujevë -Dumnicë e sheh të bllokuar nga nxënësit me çfarë logjiek prandaj është një gjë që bashkarisht mund ta ndalim qarkullimin e nxënësve jashtë oborrit të shkollës. Nxënësit nëse kanë nevojë të blejnë diçka kjo duhet të planifikohet nga DKA, që të ketë një kiosk të vogël ashtu siç është gjithkund në botë ku njerëzit kanë mundësi ta blejnë një shishe me ujë ose diçka që ju nevojitet nxënësve, sepse problemet më të mëdha ju ndodhin nxënësve jashtë oborrit të shkollës e kjo neve na duket si një lloj shkaja por në aspektin logjik kjo është shumë e shëndetshme që nxënësit mos të lejohen që të dalin gjatë pushimit jashtë oborrit të shkollës.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, fillimisht seanca e thirrur për arsim për kundër faktit që ka qenë planifikuar një raportim për këtë fushë tregon qasja e inicuesit të kësaj seance, dëshirojnë me përdorë politikisht këtë seancë veçanërisht ndaj meje personalisht, për inate goxha personale e politike, nga disa individ të caktuar brenda ish subjektit politik që isha dy vite më parë, tek e fundit opozita këtë punë e ka por gjithnjë duke u bazuar në disa parime njerëzore jo me gjithë këtë urretje patologjike ndaj meje. Si do që të jetë ne jemi këtu për t'ju përgjigjur pyetjeve tuaja gjithnjë duke respektuar integritetin njerëzor e moral të secilit prej jush me aq sa ju leni hapësirë për një gjë të tillë. Ju i përmendëtr një varg punësimesh duke u bazuar në informata jo të plota apo më mirë me thënë informata qëllim këqija e që procedurat e pranimi të kuadrave mësimor janë shumë transparente nga shpallja e konkursit e derei te pranimi i kuadrit e këtë e dëshmojnë edhe numri i ankesave minimale që janë në krahasim me vitet e kaluara. Në kuadër të DKA-së, ka një komision i cili nuk është i përhershëm por ndryshon varësisht nga profilet që pranohen në mësimdhënie duke angazhuar shpeshherë edhe anëtar të komisionit edhe jashtë DKA-së, komision ky i cili ka përfunduar një punë profesionale për çka tregon edhe numrio i vogël i ankesave lidhur me pretendimet e juaja. Meqenëse po mundoheni me ulë integritetin tim moral e njerëzor bëhuni real dhe dilni vetëm me një emër të caktuar, përmendeni vetëm një anëtar të familjes sime të ngushtë apo të gjerë, vetëm një emër nëse e gjeni unë dal para jush sot dhe jap dorëheqje. Për dallim prej jush që mua nuk më lejon karakteri të flas për punësimet e juaja të cilat i keni bërë e nuk do t'i përmendi e do t'i lë për një herë tjetër, po harroni krejt se i keni lënë njerëzit prej viti 2004 të diplomuar dhe 17 vite kanë qëndruar pa bërë asnjë ditë pune dhe ju keni menduar se do të

veprojmë njësoj si ju, jo. Nuk do të mbetet askush jashtë pozitës që e meriton dhe nuk do të qëndroj askush në pozitën që nuk e meriton duke i përfshi edhe ata drejtor e ish drejtor nëpër shkolla që ju i përmendët.

Të thoni se në DKA, çdo javë prodhohet nga ndonjë skandal është e pa pranueshme sepse faktet flasin ndryshe apo vetëm nëse për ju është skandal investimi në arsim atëhere vetëm këtë vit janë 1.500,000.00€, nga niveli komunal, 79,000.00€ nga banka botërore. Ndërtimi i çerdhes që u përmend me të drejtë këtu pas 20 viteve, këndi i lojërave për fëmijë, finalizimi i shkollës në Ballofc, furnizimi me makina pastrimi, kositëse bari, tv monitor, është bërë intervenimi në 80 shkolla për të vazhduar sivjet edhe në shkollat e tjera, rrethojat e objekteve shkollore që u përmenden me të drejtë këtu nga disa asamblistë për siguri në shkollë, furnizimi i të gjitha shkollave me lektyra të pasura shkollore, vendosja e kamerave në shumicën e shkollave dhe në procedurë të prokurimit janë edhe shkollat e fundit dhe kjo na ka dhënë hapësirë që 19 roje që kanë qenë nëpër objektet shkollore t'i shëndrrojmë në punëtor teknik për mirëmbajtjen e oborreve të shkollave dhe ju të gjithë e shuihni se gjendja është më e mirë se sa ka qenë. Pajisja me laborator e 23 shkollave dhe 11 janë në proces dhe ky aktivitet po përmbyllet sivjet për t'i dhënë hapësirë vendosjes së tabelave digjitale moderne në vitin e ardhshëm, pajisja me të gjitha mjetet e konkretizimit dhe inventarit modern në 5 klasë të nivelit parashkollor projekt i realizuar me Caritas-in, një nga investimet më të qëlluara është edhe investimi rreth 1,000,000.000€, në renovimin e shkollave përmes projektit të eficiencës e nga këto Komuna e podujevës përfiton masat e eficiencës dhe shkurtimeve e shpenzimeve nëpër shkolla, një nga elementet qenësore për menaxhim të mirë të shkollave e mbi të gjitha krijimi i një ambienti të mirëfilltë, të mirëorganizuar, ku në klasë duhet të mbizotërojë një temperaturë 20⁺, në mënyrë që të ketë edhe mësimdhënie edhe mësimnxënie. Shërbimi me psikolog dhe asistent për fëmijët me nevoja të veçanta, mbulueshmëria e kësaj fushe është 87%, e që është më së miri në nivel të republikës së Kosovës, i keni pas lënë 3 shkollat mesme që kanë qenë më shumë se 1000 nxënës dhe asnjë psikolog se kanë pasë këto shkolla, këtë asnjëherë se keni përmend, e kjo është për t'ju ardhur leq. Unë e konsideroj dhe kam qenë në atë kohë do të flasë edhe për atë temë që e ngriti z.Qendrim Softolli, unë e kam ngritë zërin për arsim dhe do ta ngrisë zërin prapë nëse është e nevojshme, mirëpo asnjëherë se keni ngritur zërin për tu angazhuar psikolog që kanë qenë domosdoshmëri e kohës ndër vite. Opozitarizmin e vëtëm që e keni bërë, kanë qenë disa shtylla të keds-it, me i vendos ose jo, me i vendos 1metër larg asfalti apo më afër asfalti. Ne jemi fokusuar sepse LVV e ka pasë prioritet arsimin. Kryetari z.Shpejtim Bulliqi e ka pasë prioritet arsimin dhe kemi vazhduar me punë të mira, kemi vazhduar edhe me donacione të ndryshme duke filluar nga ambasada japoneze këtë vit dhe një varg organizatash kredibile që veprojnë në Kosovë. Janë bërë aktivitete të një pas njëshme nga DKA, por edhe nga vetë shkollat, kemi arritë t'i kemi vendet e para në shumë gara komunale, kombëtare e ndërkombëtare dhe këto janë nga punët e mira që i kemi realizuar ne. Sa i përket konkurseve ju lutem më lejoni dhe kërkoj mirëkuptiminj për të gjithë ata që i dinë procedurat por po më detyroni me ua tregu procedurat, duke filluar nga procedura te konkursi dhe konfliktit të interesit. Fillimisht ju tregova dhe kesh shumë i hapur që asjë anëtar i familjes sime të ngsuhtë apo të gjerë (nuk është i punësuar), gjejeni ju lë afat një muaj hulumtojeni, Avni Fetahu vjen këtu në Kuvend dhe jep dorëheqje, përndryshe definicioni i konfliktit të interesit përcaktohet në mënyrë të qartë përmes ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Sipas kësaj dispozite konflikti i interesit lind nga një rrethanë me të cilën zyrtari ka interes privat që ndikon mund të ndikoj ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare, pasi që kompetent për t'i zhvilluar procedurat e konkursit sa për informatën e juaj ka qenë komisioni përzgjedhës. Anëtarët e këtij komisioni nuk kanë rezultuar të jenë në konflikt të interesit me asnjërin nga kandidatët të cilët i janë nënshtruar testit me shkrim dhe intervistës prrandaj nuk ka

qenë e nevojshme që të përjashtohet asnjëri nga anëtarët gjatë procedurave të konkursit. Rrjedhimisht konflikti i interesit nuk ka ekzistuar në asnjë stad të procedurës lidhur me këtë konkurs sepse anëtarët e komisionit përzgjedhës janë zyrtarët e vetëm të cilët kanë kompetencë në zhvillimin e procedurës rekrutuese, përfshirë përgatitjen e pyetjeve, mbarvajtjen e testit me shkrim, intervistës si dhe përpilimin e listës së kandidatëve të suksesshëm prandaj në kuptim të dispozitave të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit si dhe në bazë të legjislacionit përkatës për procedurat e rekrutimit komisioni përzgjedhës si organ kompetent ka bërë vlerësimin e drejtë të pa anshëm dhe objektiv duke mos qenë në asnjë rrethanë në konflikt interesi me kandidatët të cilët kanë aplikuar, se procedurat e konkursit kanë qenë në rregull e dëshmon edhe fakti që lidhur në këtë konkurs nuk është dorëzuar asnjë ankesë lidhur me ato drejtime ekonomike dhe juridike të cilat i përmendët ju, me përjashtim të 3 ankesave që komisioni i ankesave i është përgjigjur në drejtimin parashkollor, pra kemi vetëm 3 ankesa. Tani kur jemi te zgjedhja e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve e që po thonë se i keni marrë e i keni ndërruar unë po them se i kam marrë statistikën dhe 60%, prej tyre janë të njëjtit që kanë qenë më heret janë duke punuar, veç se janë më të relaksuar. Në fillim u patën mësuar keq edhe në ditën e shtunë për aktivitete familjare më pyesnin a bënë të shkoj dikund, i kishin pas strukur, tani janë shumë të lirë dhe shumë mirë duke punuar. Po i bëni disa goditje të cilat goditje unë i kam marrë edhe në kohën sa kam qenë në LDK, unë kur kam dalë më i votuari patët shkuar një numër i madh i juajti të z. Agim Veliu dhe i keni thënë se po don me ua marrë partinë se Avni po bënë grup e po bënë kështu, dine se në LVV, nuk ka kesi, këta janë njerëz të pa djallëzuar dhe nuk i kanë këto veti dhe këtu ju nuk mund të futni grimca (shibla) mes mje dhe këtyre sepse unë pa asnjë kusht kam kaluar në LVV, dhe i kam hy garës me rregull njësoi qysh kanë hyrë edhe këta edhe ndjehem shumë krenar kur kam kandiduar për asamble komunale s'kam hy si apaç siç keni hyrë ju por ju kam nënshtruar procesit zgjedhor dhe i falënderoj se në bazë të renditjes më kanë vendos në numrin 5. Përndryshe ju e dini se në atë rajon prej fshatit Shtedim, Ballofc, Lladofc, Shajkofc, Dumosh, e kam pasë nën përcjelljen e ish drejtorit z. Abaz Llugaliu dhe e di mirë se si ke ardhë si kandidatë i asamblesë komunale ti z. Qendrim Softolli, ke qenë te shtëpia, ke qenë i kërcënuar prej familjarëve tuaj se nëse nuk të fusin në listë të kandidatëve të LDK-ja unë shkova në LVV, këtu s'ke çka më shet këso sendesh. Përndryshe çështja e zëvendësimit nëpër shkollë, z. Gazmend Islami bëri një pyetje dhe më lejoni ta përfundoj.

z. Ilir Koprani, i drejtohet drejtorit parafoles, theksoi, nuk është tema këtu kush ka dalë në LVV e kush në LDK, mos na mbajë këtu ligjerata palidhje, mos i ndërro temat.

z. Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, kërkoj që të lejohet ta përfundoj diskutimin.

z. Ilir Koprani, replikë me parafolesin, theksoi, mos e përfundo sepse po i kalon temat, nuk kemi ardhë këtu në ligjeratë kur ke kaluar ti në LDK apo në LVV.

z. Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, duke i'u përgjigjur parafolesit theksoi, unë e kam të drejtën me përfunduar temën e ju keni të drejtën e replikës pastaj.

z. Ekrem Rrahmani, duke u ndërlidhur me drejtorin e DKA, e quan atë filozof.

Kryesues i Kuvendit, i'a tërheqë vëmendjen parafolesit që mos ta pengoj drejtorin sepse askush deri tani nuk ia ndërpreu fjalën askujt.

z. Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, theksoi, edhe njëherë e përsërisë se unë e kam të drejtën e fjalës, kurse ju mund të vazhdoni tutje pastaj, këshilltari z. Gazmend Islami bëri një pyetje dhe tani dëshiroj t'i përgjigjem.

(Këshilltari Ekrem Rrahmani ndërmori veprim duke hedh ujë me shishe në drejtim të drejtorit të DKA-së, dhe si pasojë e kësaj për disa qaste ndërpritet zhvillimi i seancës deri sa të ketë konsultime me Kryesuesit dhe përfaqësuesve të subjekteve politike brenda Kuvendit)

Kryesuesi i Kuvendit, i drejtohet z.Ekrem Rrahmanit duke e kritikuar për gjestin dhe duke e quajtur gjest të pahijshëm.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, duke i'u përgjigjur këshilltarit Rrahmani, theksoi, veprimi është çoroditur i një kandidati që nuk e ka iden se për çka është sjellur këtu, por sido që të jetë ne jemi këtu për t'ju përgjigjur disa pyetjeve.

Kryesues i Kuvendit, kërkoj nga këshilltari z.Ekrem Rrahmani ta liroj sallën e mbledhjes së Kuvendit si shkak i gjestit që e bëri, ngase siç potencoj, këtu nuk kemi të bëjmë me çështje personale asgjë, këtu jemi përfaqësues të popullit dhe ta kuptojmë këtë gjë.

znj.Adelina Stublla, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së theksoi, me këso sjelljesh ne nuk jemi në gjendje ta vazhdojmë seancën sepse këto sjellje të dërgojnë mbrapa e jo përpara.

Lëshohet mbledhja nga Grupet e këshilltarëve të LVV-së, AAK-së, PDK-së dhe nga këshilltari i OBKD z.Gazmend Islami.

z.Qendrim Softolli, kërkoj nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së të qëndrojnë në sallë dhe të ballafaqohemi me faktet, kurse lëshimi i mbledhjes është mënyra më e lehtë.

znj.Donjetë Sheqiri, duke i'u drejtuar Grupit të LVV-ës theksoi, këtë e keni pritur me dalë jashtë, me i ik përgjegjësisë.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe njëherë e përsëris se ne këtu asgjë nuk kemi personale, askush me askund, andaj është mirë t'iu shmangemi situatave të tilla.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryesues nuk ka nevojë ai (drejtori i DKA-së) të përmend emra këtu duke thënë se ka thënë apo s'ka thënë NN peroni kështu ashtu, prandaj ai po bëka me pas diçka personale kurse ne jo.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe njëherë po e përsërisë, i nderuar zotëri Rrahmani, ne të dy këtu s'kemi asgjë personale apo familjare mes veti, mirëpo gjesti yt që e bëre është për tu dënuar dhe këtë po jua them shkurt dhe haptas.

z.Ekrem Rrahmani, pyet Kryesuesin e Kuvendit se a i din procedurat sa i përket largimit nga mbledhja të ndonjë këshilltari, nëse vendos ashtu urdhëro hedhe në votim e jo të më thuash liroje sallën.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, replikë me parafolësin theksoi, po jam në dijeni për proceduat e tilla.

z.Qendrim Softolli, kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit që të ketë një pauzë të shkurtër.

Kryesues i Kuvendit, njofton të pranishmit se Kuvendi shkon në pauzë për 20 minuta, pra deri rreth orës 12;40

Pas Pauzës, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se meqë arritën 18 këshilltarë/e në sallë (edhe pse fillimisht në sallë ishin vetëm 16 këshilltarë/e nga 35 sa është numri i përgjithshëm i Kuvendit) andaj mbledhja mund të vazhdoj

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pas pauzës prej 20 minutave që ishte me kërkesën e Grupit të Këshilltarëve të LDK-së, dëshiroam ta vazhdojmë seancën por si duket për momentin të pranishëm në sallë janë vetëm 14 këshilltarë/e të Kuvendit.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të lejohet vetëm një deklaram i shefit të Grupit të këshilltarëve të LDK-së rreth situatës së krijuar e pastaj të shikohet edhe njëherë se a ka kuorum për të vazhduar me seancën ngase siç duket kuorumi ekziston vetëm sa të hyjnë brenda edhe disa këshilltarë të Kuvendit.

Kryesues i Kuvendit, fton shefin e Grupit të këshilltarëve të LDK-së ta merre fjalën, mirëpo për vazhdimin e seancës nuk e di si mundemi sepse seanca u ndërpre njëherë edhe pse po lejoj një deklaram.

z.Valon Demolli, theksoi, për gjestin që ndodhi ju kërkojmë falje për shkak se ka qenë në afekt dhe u dakorduar që anëtar i asamblesë të kërkoj falje dhe ta liroj sallën, mirëpo Grupi i këshilltarëve në pushtet nuk janë në gjendje që të kthehen në sallë. Këto provat tona materiale që i kemi do të thotë se drejtori z.Avni Fetahu, i ik përgjegjësisë dhe nuk don të deklarohet dhe e gjetën mundësinë e vetme për t'i ikur kësaj seance.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari zotëri Kryesues, së pari kërkoj falje për situatën që ndodhi edhe kjo është pjesë e zhvillimeve në Kosovë dhe në demokracinë e Kosovës e praktikuar shumë herë para nesh por po më duket për herë të parë te ne ka ndodh kjo. Çfarë desha të them është se neni 32.3, situatën ku gjendemi ne e rregullon kjo dispozitë e rregullores së punës së kuvendit, andaj po e citoj; në rast se gjatë mbajtjes së mbledhjes kryesuesi i Kuvendit konstaton se nuk ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje e ndërpret mbledhjen dhe e cakton kohën e fillimit të vazhimit të mbledhjes.

z.Illir Koprani, theksoi, i nderuar Kryesues, kuorumi ekziston dhe konsideroj se mund të vazhdohet me seancën.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, fillimisht të konstatohet kuorumi pastaj kërkoj dhe i drejtohem këshilltarit të Kuvendit z.Ekrem Rrahmani që të dal publikisht dhe të deklarohet dhe të kërkoj falje, edhe pse pavarësisht është e drejtë e tij.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari zotëri Kryesues, kuorumi ekziston dhe mund të vazhdojmë me seancën.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, i nderuar zotëri Çunaku, mbledhja u ndërpre njëherë andaj nuk di se të veprohet në këtë situatë.

znj.Triga Sfishta, theksoi, i nderuari Kryesues, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-ës jemi për vazhdimin e mbledhjes, pra tani erdhën këshilltarët tjerë sepse këtu kanë qenë por nuk kanë ditë se po fillon mbledhja.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, tani janë bërë 20 minuta të pauzës dhe rrjedhimisht tani janë ardh edhe këshilltarët tjerë dhe kuorumi ekziston dhe mund të vazhdohet me seancën.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë kërkoj falje për gjestin e bërë edhe pse jemi opozitë dhe kemi të drejtë, ne kemi raste edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës kur tani Kryeministri aktual e ka gjuajtur me vezë ish kryeministrin Isa Mustafa dhe nuk është bërë aq e madhe, kanë hedhë edhe gas lotësjellës në Kuvend kurse unë ia hedha 3 pika ujë mirëpo ai ishte pakës i nxehtë dhe e filladita. Ne e ruajtëm fortë në fjalimet tona, ai temen e shëndërroj në personale dhe filloj të përmend emra për atë arsye ndodhi ajo, kështu që pasi edhe ju po thuani unë po kërkoj falje.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, njeriu kur kërkon falje asgjë nuk dobësohet, është vlerë njerëzore kërkim falja, faleminderit shumë.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, zotëri Kryesues tani janë bërë 20 minuta nga koha e pauzës dhe ne kemi filluar me vazhdimin e mbledhjes më herët, kështu që asamblistët nuk kanë faj për vonesën.

z.Gazmend Islami, theksoi, unë nuk e dita që kemi filluar mbledhjen ishte koha e drekes.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe njëherë e konstatojmë se a kemi kuorum për punë, pas pauzës prej 20 minutave shihet se janë krijuar kushtet për punë, tani në sallë të Kuvendit të pranishëm janë 18 asamblistë, kuorumi ekziston dhe mund ta vazhdojmë seancën, ose këtë seancë mund ta vazhdojmë një ditë tjetër, nëqoftë se keni ndonjë propozim konkret urdhëroni.

z.Valon Demoli, theksoi, zotëri Kryesues ne mendojmë se duhet ta vazhdojmë senacën.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, atëherë vazhdojmë me seancën.

z.Valon Demoli, theksoi, kur dëgjohen gjithë këto shkelje dhe keqpërdorime që janë bërë nga Drejtoria e Arsimit, sigurisht për këto ka qenë i informuar edhe Kryetari z.Shpejtim Bulliqi, por edhe drejtorët dhe kolegët asamblistë, për të gjitha këto na bjen në mendje një gjë apo ju pengojnë këto skandale juve që jeni në pushtet. Disa koleg që në çdo seancë na shesin moral a i keni parë këto punësime apo të gjithë jeni të përfshirë, dikush i ka kryer punçësimet e dikush pret në radh për t'i kryer. Më i zëshmi ka qenë në këtë temë kolegu z.Haki Rudari, i cili për shumëkohë punon në arsim. E nderuar udhëheqje e komunës, fatkeqësisht nuk janë këtu, si ndjeheni kur jeni në dijeni se sipas pozitës jeni bashkëfajtor për të gjitha këto shkelje ligjore që janë bërë, a ndjeheni penalisht përgjegjës, nëse jo të paktën a ndjeni përgjegjësi morale dhe njerëzore nëse jo institucionale. Cilat do të jenë veprimet konkrete sa i përket shjelleve ligjore të lartcekura nga kolegët, a do ta pyesni shefin tuaj të nivelit lokal nëse do të ndërmerrni masa për shkarkim nga detyra e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, të paktën një kërkim falje qytetarëve Llapjan e në veçanti atyre që ua keni mohuar të drejtën e punësimit e që dihet se sa i rëndësishëm është një vend i punësimit për ata qëç i kanë përfunduar studimet. A do të ngritni ndonjë komision të brendshëm për të gjitha këto parregullësi sa i përket konkurseve të Drejtorisë së Arsimit, a do t'i publikoni ato kontrata dhe numrat e protokollit për vitin 2021, 2022, si dhe numrin e orëve për secilin të punësuar pasi që keni informata dhe fakte se gjatë vitit 2021, në pension kanë dalë rreth 50 anëtar, ndërsa gjatë këtij viti janë punësuar mbi 100 persona, i bie që mbi 50 persona janë punësuar pa kurrfarë nevojë dhe kurrfarë procedure të rekrutimit e njëjta raportohet çdo ditë e gjithmonë thuhet se nga lista e pritjes. Cili ligj e parasheh këtë listën e famshme të pritjes dhe qysh u bë puna që gjithnjë në listën e pritjes janë anëtarët e LVV-së, apo kjo është arsyeja pse ende nuk e zbatoni ligjin për t'i përcaktuar vetë listat, këto janë arsyetime koti. Gjithë ky punësim me këto keqpërdorime të bën të kuptosh se për të gjitha këto ka elemente korrupsioni dhe forma me të ciklat kanë përfituar këto pozita prandaj si shef i Grupit të këshilltarëve të LDK-së, i bëj thirrje organeve të rendit të merren me faktet që ne i paraqitëm sot, ndërsa mediave do ua dorëzojmë gjithë materialin dhe faktete të cilat ne i posedojmë.

z.Arjant Topanica, theksoi, jemi dhe ishim këtu në njërën nga seancat më të rëndësishme të këtij mandati, jemi këtu për të folur për një nga temat më të ndjeshme që i takon çdo qeverisje, jemi këtu për të folur për të tashmen dhe të ardhmen tonë, pra jemi këtu për të folur për gjendjen në arsim. Fatkeqësisht unë dua t'ju kërkoj ndjesë qytetarëve që po flas nga vedi ku jam ulur e jo nga foltorja e Kuvendit, por këtë e bëj për shkaqe shëndetësore e këtu më ndërlidhet fakti me rëndësinë që i dha vetë drejtori kësaj teme duke folur nga vendi ku ishte ulur për njërën nga temat më të rëndësishme të kësaj legjislature. Unë shkurtimisht do i përmend dy ose tri pika për të cilat dua përgjigje nga drejtoria dhe nga kjo qeverisje, si pikë e parë është fillimi i vitit shkollor aktual duke e ditur se vijmë nga një vit paraprak me shumë mungesa si shkak i pandemisë dhe ky vit filloj me dy ose tri javë me vonesë, por ndonëse këto vonesa nuk i mjaftuan DKA-së për tu pajisur me pajisjet e nevojshme për mbajtjen e mësimi, asaj iu desh që të shkohet deri në fund të tetorit për tu pajisur me ditar dhe pajisje tjera shkollore për të filluar mësimi i rregullt. Kjo ka një përgjigje, kjo është bërë për arsye të mosdakordimit të kësaj drejtorie me pazaret e tenderëve që janë bërë për pajisjen e shkollave me këto materiale. Shqetësim tjetër janë edhe kabinetet që i kemi parë se janë reklamuar shumë nëpër rrjetet sociale ku postohen foto, mandaj mbahen edhe fjalime nga drejtori se krenoheshin nga këto kabinete, mirëpo kemi hasur shqetësime të shumta nga nxënësit dhe mësimdhënësit se këto kabinete nuk janë funksionale e fakti më i freskët është në javët e fundit gjatë mbajtjes së testit pisa ku i tërë territori i Komunës së Podujevës nuk ishte në gjendje që t'i siguroj dy kabinete të informatikës që do të mbaheshin këto teste pa problem. Kështu që dita e parë e testit u humb, u shty për ditën tjetër dhe çka ndodhi në ditën tjetër kur vihet prapë edhe ndonëse me ndihma nga jashtë nuk arrihet që të

përfundohet ky test dhe në fund dy nga nxënësit që ishin duke u testuar iu fshihet përmbajtja e testit dhe detyrohen që të vijnë sërish në ditën e tretë për t'ju nënshtruar testit pisa . Kur të gjitha këto ndodhin në procedura të mbajtjes së testit atëherë çka pritët nga rezultati i këtij testi pisa, për fund unë shpresoj se fëmijët dhe nxënësit tanë mos ta kenë dëgjuar këtë mbledhje, por shpresoj shumë në të njëjtën kohë që prindërit e tyre ta dëgjojnë shumë me vëmendje dhe t'i kushtojnë shumë rëndësi dhe të jenë shumë të vetëdijshëm në proceset vendimarrëse në të ardhmen kur zgjedhet udhëheqja e qeverisjes lokale e që ajo udhëheqje është përgjegjëse për të ardhmen e fëmijëve të tyre, fëmijëve tanë dhe të gjithë neve.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, fatkeqësisht fëmijët sot ne i kemi në shtëpi, kanë me na përcjellë dhe me na pa neve si prind.

z.Arjant Topanica, përgjigje Kryesuesit theksoi, për atë edhe shpresova se nuk do të na shohin.

znj.Arjeta Abazi, theksoi, së pari kisha dashur që drejtori i DKA-së të jetë prezent këtu në këto momente por ndodhi siç ndodhi dhe bashkëpartiaku ynë veç se kërkoj falje, unë prapë po dal me një kërkesë dhe me disa parregullësi siç i din edhe drejtori i DKA-së, që kanë ndosh. Së pari dua të them se është për keqardhje dhe fatkeqësi kur për një fushë vitale për vendin tonë siç është arsimit dhe edukimi ndodhin gjithkëto keqpërdorime dhe atë në një periudhë kaq të shkurtër kohore, nëse njerëzit që kanë qenë vetë punëtor të arsimit për vite të tëra dhe kanë fituar vota e kanë ardhëm në pushtet me premtime për ndryshim dhe në këtë mkohë të shkurtërt bëjnë kaq parregullësi kjo na dëshmonë qartë se gjithçka çka është thënë ka qenë mashtrim sepse këta po tregohen se nuk kanë kurrfarë ndjeshmërie për arsim. Paramendojeni vendi ku marrin udhë e përgatiten gjeneratat e së ardhmes të trajtohen kështu, kjo në një kompani private me ndodhë është e pa pranueshme e lere më në institucion. Po ndalem pak te çështja e bursave, skandal në vete ku si pasojë e pa përgjegjësisë humbën mundësinë e përfitimit meritator formë e cila u përdor në kuadër të konceptit të ndryshimit e që përfundoj dukël u shkaktuar komisionin përzgjedhës e kush e ka pasur fajin dihet. Nuk e di nëse anëtarët e atij komisioni a janë të shkarkuar a po ka ndodhur vetëm në konferencën për media, pra për herë të parë kriuteret janë përcaktuar pasi që është bërë përzgjedhja e përfituesve. Vazhdojmë me bibliotekat e shkollave se cila është qasja e drejtorisë për to tregon fakti se si angazhohet stafi në to ose ndonjëri i punësuar pa konkur që dërgohet për akomodim ose duke angazhuar ndonjë drejtor e indëshkuar për shkak që nuk iu bindet dhe ia plotësojnë normën duke i thënë jpjani edhe 10 orë në bibliotekë, mundeni me marrë me mend me çfarë dëshire punojnë ata pastaj. Tani po fokusohemi në një temë tjetër shumë evidente në fushatë e nga premtimet për të cilën moren shumë mbështetje edhe në zgjedhjet e para të jashtëzakonshme por edhe në këto të fundit në obligimet që dalin nga kontrata kolektive e arsimit. Drejtor edhe pse nuk është këtu a jeni të vetëdijshëm se Drejtoria e Arsimit nuk i ka përmbushur obligimet që dalin nga kontrata kolektive dhe për këtë arsye është paditur nga punëtorët e arsimit. Këto padi në bazë të informatave që i kemi janë shumë afër vendimit final nga ana e gjykatës, pra punëtorët e arsimit së shpejti do t'i realizojnë të gjitha benefitet që dalin nga kontrata kolektive siç janë pagat jubilarë, shujtat dhe pagesat e udhëtimit. Sipas një përlllogaritje kostoja e këtyre obligimeve që ju edhe vet e keni cekur disa herë ështëç rreth 2,000,000.00€, ju si pushtet në buxhetin e vitit 2022 nuk e keni planifikuar një shumë të tillë për këtë çështje. Sipas rregullatives ligjore departamenti i thesarit në Ministrinë e Financave pas vendimit të Gjykatës ekzekutimin e bënë duke tërhequr automatikisht mjetet nga buxheti i Komunës. Ju në këtë rast me mosplanifikimin tuaj do ta dëmtoni seriozisht buxhetin e komunës sepse do të duhet t'i anuloni shumë investime kapitale të parapara në vitin 2022. Siç po shihet bazuar edhe në atë që deklaruan parafolësit e mi preukopimi i juaj kryesor paska qenë akomodimi i familjarëve dhe aktivistëve e jo fati i punëtorëve të arsimit e aq më pak taksat e qytetarëve. Siç po shihet bazuar edhe në atë që than parafolësit konstatohet se në dy proceset zgjedhore premtimi i juaj për mësimdhënësit për shujtat

paska qenë mashtrim, herën e parë mund të justifikoheni sepse buxhetin e keni gjetur të miratuar edhe pse keni pasë mundësi në rishikim, ndërsa herën e dytë me vetëdije keni mashtruar dhe nuk keni paraparë buxhet për këtë çështje.

z.Gazmend Islami, theksoi, së pari më vjen keq që pozita doli nga salla e kuvendit, mirë që asamblisti kërkoj falje sepse përvojat mesazh të keq kështu, të gjithë vijmë nga rajoni i njëjtë dhe njihemi mes veti andaj këtu po e paraqes një shqetësim të nxënësve të fshatrave Murgullë, Tërnavicë, sepse paralelet e shkollave atje nuk janë funksionale dhe ata mësime kanë mbetë rrugëve, ata pranojnë mësime të ri por është një shqetësim sepse po të ishte një qeverisje normale e ndershme nuk mund t'i hedh në rrugë mësime të cilët kanë punuar me vite të tëra kurse tani për shkak të mbylljes së shkollave me mbet pa punë, për këtë çështje do të ishte mirë të jetë prezent drejtori i DKA-së por ai nuk është prezent këtu. Nga opozita sa i përket çështjes së arsimit kërkoj që të jenë shumë më serioz në kuptimin që të kemi një edukim sa më të mirë sa më serioz duke e kritikuar të keqen duke gjetur gabimet e qeverisjes, a ka punësime familjare, ka sa të duash, a ka emra ka sa të duash, ato janë për me i dërgue në prokurori dhe me i paditë sepse ne tash nuk mund t'i marrim emrat e secilit. Nga ana e juaj kërkoj që në mbledhjen e ardhme të bashku opozitë e pozitë ta krijojmë një trupë të përbashkët për çështjen e arsimit, kjo është në të mirën e të gjithëve. Sa i përket atyre kositësve të barit që po i përmendin sot kujr kam ardhë prej Dumnices e kam pa barin pa u kositur sepse ato kosa nuk janë funksionale p-ra ato kositës vetëm i kanë ble dhe i kanë lënë dikund se nuk ka kush që i shfrytëzon këtu, pra është një marketing i keq i pozitës.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, roli i mësimeve pa dyshim se është rol i shenjtë e roli i atij që udhëheq me këtë sektor sigurisht është i një rëndësie të madhe, fakti që në komunën tonë edhe udhëheqësi i ekzekutivit por edhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit vijnë nga fusha e arsimit, është dashur që të jetë lajm i mirë për arsimin në Llap, por veprimet e lartcekura dhe mos prezenca e tyre këtu dëshmojnë që kjo ishte një fatkeqësi për Llapin. Mësimeve llapjan me shumë vështirësi po vijnë deri te vendi i punës, pranohen për normë të plotë por këta ua masakrojnë normat duke i ndarë vazhdimisht orët e tyre e duke ua dhënë secilit militant nga 10 orë për të blerë paqe e bashkë me paqen edhe votat, sigurisht për t'i shlyer borxhet elektorale. Nëse skandalet e përditshme që po i prodhoni janë në kuadër të ndryshimit që ju e keni premtuar amani ju qoftë ndaluni, ndaluni se ia dolët, përnjëmend e keni ndryshuar ama për të keq fatkeqësisht boll keq ka qenë por ju e keni degraduar totalisht. Kjo është skandaloze e sidomos kur vjen nga ata kur gjithë kohën kanë qenë veç kritika dhe gjithçka që kanë pa para tyre ka qenë vetëm zi. Duke qenë se edhe vet shkollimin e mesëm e kam përfunduar disa vite më parë në atë shkollë po dua të ndalem pak te shkolla e mesme ekonomike “Isa Boletini”, në Podujevë. Kjo shkollë e ka pas një performancë të jashtëzakonshme nga ish drejtori i shkollës e këtë më së miri e din drejtori i Drejtorisë së Arsimit që nuk është këtu se goxha kohë edhe ai vet ka shërbyer aty e besa goxha e pat lavdruar punën e tij sa ka qenë drejtor e ça ka bë tash kur është bërë drejtor i Drejtorisë së Arsimit, e kanë larguar arbitrisht drejtorin e shkollës menjëherë pasi që i kanë fituar zgjedhjet. Të njëjtën pozitë kanë emëruar njerëz partiak të cilët një muaj para fushatës zgjedhore i ka promovuar vetë në parti, i ka prezantuar publikisht si aderim në LVV, me një tekst që është përbetuar me ndryshimin e famshëm e që në fakt ndryshimet kanë ndodhë por për keq fatkeqësisht. Gjimnazi si vend ku më parë rexishte nxënësit elitë e që më parë kanë qenë profesor elitarë për fat të keq e kanë shëndërruar në çerdhe të militantizmit e punësimit partiak e këtë po ua mundëson drejtori i ri i cili me plotë vëmendje mund të quhet drejtori më i dëgjueshëm në Komunën e Podujevës, e të cilit dëgjueshmërinë e tij ia kanë shpërblyer me punësimin e bashkëshortes. Në listën përfundimtare, listë e publikuar në faqen zyrtare të Komunës së Podujevës kandidatja është shpallur e pa pranuar nga rezultatet e publikuara por prapë me qëllim të shpërblimit të drejtorit të dëgjueshëm ju i keni bërë kontratë pune në atë pozitë.

Paramendojeni qytetarë shpallet e pa pranuar nga një konkurs por pranohet me kontratë në punë dhe sot punon në shkollën e mesme “Isa Boletini”, e kjo bënë vaki veç te qeverisja e ndryshimit sigurisht në moton krejt dhe drejt. Kjo është lista zyrtare që ka dalë në ueb faqen e Komunës së Podujevës (prezanton listën). Nëse vetëm një proklamim i përezantuar i LVV-së ka mbetur gjallë në këtë Kuvend, po siç po shihet ka vdekë, secili prej jush është dashur të distancohet prej veprimeve të lartcekura dhe të dilni e t’i kërkonit falje të gjithë qytetarëve llapjan, të cilët i kanë mashtruar me slloganin për barazi e ndryshim. Krejt në fund qytetarët nuk harrojnë të jenë të bindur e ne do të jemi këtu për t’i vendosur në pah parregullësitë e juaja edhe pse keni menduar se nuk ka opozitë.

z.Valon Demolli, theksoi, fillimisht desha të ndërlidhem te shkolla “Isa Boletini”, ku drejtori vetë e ka formuar komisionin dhe vetë e ka përgatitur konkursin, vetë i ka përcaktuar kriteret e konkursit, do të thotë kriterin e masterit MSC dhe në fund vetë ka pranuar kandidatë me titullin bachelor, çka i bie kjo drejtor. Po ndërlidhem te konkursi asistent për fëmijët me nevoja të veçanta pasi që janë pranuar dy familjar të afërm të Kryetarit z.Shpejtim Bulliqi, pa kualifikim adekuat dhe nuk janë pranuar kandidatët që janë në përfundim të kualifikimit. I bëj thirrje auditorit të përgjithshëm pasi që është në komunën tonë që ta kontrolloj listën e pagave të muajit shkurt ku shihet se z.Avni Fetahu, i ka marrë dy paga, një pagë të plotë si asamblist dhe një pagë të plotë si drejtor, plus kompensimin prej 189€, apo na tregoni z.fetahu kur keni dhënë dorëheqje nga asambleja, kur je emëruar drejtor pasi që njërin pagë e ke marrë jashtëligjshëm dhe me këtë ke bërë konsumimin e veprës penale për mashtrim dhe fatkeqësisht nuk je i vetmi.

z.Qendrim Softolli, theksoi, dua të ndërlidhem dhe të japë një informatë për procesin e rastit të transferit të nxënësës Dafina Ferizi nga drejtimi i ekonomisë në mjekësi. Nxënësja në fjalë ka qenë e rexhistruar me kohë në drejtimin ekonomi profili financa dhe sigurime, Dafina Ferizi kalon më datë 15.12.2021, në profilin e mjekësisë, profili farmaci, këtë ia mundëson Drejtoria e Arsimit dhe drejtoria e shkollës pa plotësuar asnjë kriter ligjor. Emri i vëhet në ditar më datë 28.12.2021, kurse mësimi mbaron më datë 30.12.2021, do të thotë ajo atje notohet nga të gjithë mësimdhënësit përveç lëndës së fizikës dhe pas kësaj periudhe pa pasur të drejtë ajo vazhdon procesin mësimor pa pasur të drejtë duke shkelur ligjin edhe këtë herë. Pas kësaj situatë në vazhdimësi bëhet presion t mësimdhënësit nga drejtori z.Avni Fetahu, disa procedohen edhe në komision disiplinor ku merren masa ndalesë në pagë, tani krejt vonë formohet një komision jo adekuat jo i lëndës përkatëse të fizikës dhe i vendoset notë nga komisioni në mënyrë që të mbyllet kjo situatë. Keni bërë shkelje të një pas njëshme, a ka kërkesë nga nxënësja për transfer në drejtorinë e arsimit, ia bashkangjes edhe dy dokumente që i kemi që tashmë janë asgjësuar nga drejtori në fjalë dhe nuk gjenden ose nga ekzekutivi i shkollës dhe nuk gjenden në arkivat e shkollës këto dukomente po i publikoj dhe ju kamera mund t’i fokusoni lirisht. Kam edhe disa pyetje mirëpo drejtori nuk është këtu po pres herave tjera.

Nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12;20

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0035926/22

Podujevë,

20 maj 2022

Kryesuesi i Kuvendit

Hilmi Hoxha